

1. PJESËMARJA NË TREGUN PRIMAR TË EMËTIMIT TË TITUJVE TË QEVERISË

Komisioni që mbahet për ç'do aplikim të klientit për të marrë pjesë në tregun primar të emetimit të titujve të Qeverisë është 0.3% e shumës së pjesëmarrjes me minimum ekuivalentin e 15 EUR dhe maksimumi komisionit ekuivalenti 100 EUR

Shembull

Rasti ; Një klient do të blejë tituj të Qeverisë me vlerën nominale 1,000,000 LEK.

Përlllogaritja e komisionit; Komisioni që do të mbahet klientit në momentin e aplikimit do të jetë 3,000 LEK (0.3% * vlerën nominale)

2. BLERJA E TITUJVE TË QEVERISË NGA PORTOFOLI BANKËS

Në rast se klienti do të blejë nga portofoli i bankës, atëherë nga ana e bankës nuk aplikohet asnjë komision por në bazë të ditëve të mbetura deri në maturim dhe yield-it të titullit bëhet përlllogaritja e çmimit të blerjes

Shembull

Rasti ; klienti do të blejë Bono Thesari nga portofoli i bankës me maturim 1- vjeçar me yield- in të barabartë me 8% për vlerën nominale 5.000.000 lekë dhe ditët që kanë mbetur deri në maturim janë 220.

Përlllogaritja e çmimit të blerjes; çmimi i blerjes = Vlerë nominale / (1+(yieldi *Ditë deri në maturim/ 365)).

Pra çmimi i blerjes = $5.000.000 / (1+(8\%*220/365))$. Çmimi blerjes do të ishte 4.769.995 LEK

3. SHITJA E TITUJVE TË QEVERISË PËRPARA DATËS SË MATURIMIT

Në rast se klienti do të shesë titujt e Qeverisë përpara datës së maturimit, atëherë nga ana e bankës nuk aplikohet asnjë komision por në bazë të ditëve të mbetura deri në maturim dhe yield-it të ofruar bëhet përlllogaritja e çmimit të shitjes

Shembull

Rasti ; klienti do të shesë Bono Thesari me maturim 1- vjeçar me vlerë nominale 5.000.000 LEK dhe ditët që kanë mbetur deri në maturim janë 130. Për efekt të shembullit yieldi ofruar do të jetë 7.8%

Përlllogaritja e çmimit të shitjes; çmimi i shitjes = Vlerë nominale / (1+(yieldi *Ditë deri në maturim/ 365)).

Pra çmimi i shitjes = $5.000.000 / (1+(7.8\%*130/365))$. Çmimi shitjes do të ishte 4.864.850 LEK